

**THE GRAMMATICAL NATURE OF THE MOMENT OF DISCOURSE,
AS A POINT OF REFERENCE
NATYRA GRAMATIKORE E ÇASTIT TË LIGJËRIMIT, SI
PIKËREFERIM KOHOR**

Muhamet REÇICA¹

^{1*} Phd candidat of Faculty of Philology, University of Prishtina „Hasan Prishtina”

Abstract

Each and every action, situation, event or phenomenon occurs in an objective temporal reality, therefore, in order to achieve the most efficient communication, the existence of these phenomena, which are the subject of communication, the speaker must present them as accurately as possible from the temporal aspect as well. While the nature of being “grammatical facts” is recognized to tense references, there is no way they for them not to be recognized as relevant language categories that need adequate treatment, confirming the real grammatical weight in linguistic theory, despite the tacit opinion that tense references, as instances or moments with defining functions of the temporal character of a verbal form, in the process of discourse have the character of a “non-linguistic entity”.

Keywords: *time system, reference point, moment of discourse, speech act, objective time, grammatical time.*

Përmbledhje

Çdo veprim, gjendje, ngjarje apo dukuri ndodh në një realitet kohor objektiv, prandaj folësi, për arsye të realizimit të një komunikimi sa më efikas, ekzistencën e këtyre fenomeneve, të cilat janë objekt komunikimi, duhet t'i paraqesë sa më saktësisht edhe nga aspekti kohor. Derisa pikëreferimeve kohore u pranohet natyra e të qenit “fakte gramatikore”, s'ka se si të mos pranohen edhe si kategori relevante e gjuhës që donë trajtim adekuat, duke ua konfirmuar peshën reale gramatikore në teorinë e gjuhësisë, pavarësisht mendimit të heshtur se pikëreferimet, si çaste a momente me funksione përcaktuese të karakterit kohor të një trajte foljore, në procesin e ligjërit kanë karakterin e një “entiteti jolinguistik”.

Fjalët kyçe: *sistemi kohor, pikëreferim, çast i ligjërit, akti i të folurit, kohë objektive, kohë gramatikore.*

Objekti, qëllimi dhe metodat

Pikë momentet kohore që kanë funksionin referues për karakterizimet kohore të trajtave foljore në gjuhën shqipe dhe raportet reale të ngjarjeve të vendosura në kohë në struktura ligjërimore të gjuhës shqipe janë objekt vështrimi i këtij punimi, si një përpjekje për të hulumtuar, analizuar dhe sistemuar trajtat e sistemit foljor të shqipes në përdorimin praktik të tyre në ligjërim në përjasje me momentin e të folurit (çastin e ligjërimin), me natyrën e tij gramatikore të një pikëreferimi kohor.

Natyrisht se realizimi i këtij punimi ka imponuar gërshetimin e disa metodave, nëpërmjet të cilave është synuar arritja e objektivave të punimit, siç janë induksioni, deduksioni, analiza, abstraktimi, konkretizimi, përgjithësimi, argumentimi etj. Edhe metoda e vrojtimit dhe ajo statistikore janë ndërthurur me të tjerat, mbi bazën e të cilave janë nxjerrë konstatimet e nevojshme. Për realizimin e këtij punimi janë zbatuar edhe metodologji përshkruese, analitike e interpretuese, të cilat është vlerësuar se i kontribuojnë thellimit dhe zgjerimit të analizës, si dhe ndihmojnë thelbësisht në cilësinë e përgjithshme të punimit dhe në nxjerrjen e përfundimeve rreth çështjeve të lartpërmendura.

1. Hyrje

Natyra gramatikore e çastit të ligjërimin (e kohës së të folurit), pastaj roli i folësit në këtë mes, pikëmomente të tjera orientuese për referimin kohor, raportet reale të ngjarjeve të vendosura në kohë, karakteri relativ dhe ai absolut i përcaktimit të kohës gramatikore do të jenë në qendër të interesimit gjatë shtjellimit të këtij punimi. Megjithatë, pikëvështrimi qendror do të orientohet në zbardhjen e pozicionit që zë çasti i ligjërimin si një prej pikave të referimi kohor, duke bërë përpjekje të tregohet karakteri i lidhjeve dhe i varësisë së kësaj pike referuese me vetë trajtën foljore ose me strukturën e thënies në tërësi, në të gjitha rrethanat e shfaqjes së veprimeve, gjendjeve a dukurive të dhëna nga trajtat foljore në kontekste të ndryshme ligjërimore.

1.1. Natyra e përdorimit të varur dhe të pavarur të trajtave foljore të shqipes

Sipas kriterit të pikëreferimit kohor, trajtat foljore të shqipes kanë natyrë përdorimi të karakterit absolut dhe relativ. Në rrafshin absolut, respektivisht në përdorim të pavarur dhe të pandikueshëm të foljes në thënie, në një proces normal komunikimi, jashtë çdo ndërhyrjeje a ndikimi subjektiv në organizimin e thënies, duke e pranuar rrjedhshmërinë e natyrshme të ligjërimin, megjithatë objektivisht ekziston një pikë, së cilës i referohen format foljore në thënie të strukturave të ndryshme, moment që ka të bëjë me **kohën e të folurit**. Në praktikën shkrimore, me vlerë funksionalisht të njëjtë këtë pikë pretendon ta ketë edhe vetë akti i shkrimit.

Çdo thënie e realizuar nga një folës, në një moment të caktuar objektiv merr karakterizim kohor në bazë të tri pikëreferimeve:

- çastit kohor kur flitet, si e tashme objektive e folësit,
- kohës së shqiptimit të thënies, si dhe
- kohës së veprimit foljor.

Krahas këtyre pikëreferimeve, në struktura të përbëra thëniesh edhe momenti kohor i një trajte foljore mund të funksionojë si pikëreferim për një trajtë tjetër foljore në të njëjtën thënie, fakte që për shkak të kufizimeve objektive nuk mund të trajtohen me këtë rast.

Tabela 1. Natyra gramatikore e pikëreferimeve kohore.

Pikëreferimi	Çasti i ligjërimit (situata e të folurit)
	Koha e shqiptimit të thënies
	Koha e veprimit foljor
	Funksioni orientues i një trajte foljore për veprimin e një trajte tjetër foljore në thënie

1.2. Funksioni pikëreferues i çastit të ligjërimit

Shqyrtimi i natyrës gramatikore të çastit të ligjërimit (*momentit të të folurit*), në funksion të krijimit të “identitetit” kohor të trajtave të ndryshme foljore në gjuhën shqipe del më se i nevojshëm, në mënyrë që të kuptohen të gjithë faktorët gramatikorë që mundësojnë realizimin e karakterizimit kohor të trajtave foljore të sistemit kohor të shqipes. Duke e parë funksionin e patjetërsueshëm referues të çastit të të folurit në shprehjen e marrëdhënieve kohore, shtrohet pyetja cila është pesha reale gramatikore e këtij çasti, nëse mund të quhet fare “çast”, qoftë edhe vetëm për arsye praktike gjuhësore.

Natyrisht, situatën e të folurit a të ligjërimit nuk e ‘ndërton’ një çast i vetëm, por pikëmomente të shumta kohore, pra një periudhë a një segment më i gjerë kohor, të cilit është gati e pamundur t’i përvijohen kufij, megjithëse ka karakteristikat e një fakti real, objektiv, gramatikor. Kështu, në një situatë të këtillë komunikimi:

-Unë kisha punë me veten time dhe jo me shoqërinë. Aq më bënte për shoqërinë, nuk më hante palla nëse këto gjeste dhe ky refuzim që në të vërtetë nuk ishin as gjeste, as veprime, nuk bëhej për të shtyrë përpara proceset ose për t’i zbrapsur ato. (Basha, 2011, 64).

Nuk mund të mos kihet parasysh fakti se nga aspekti gramatikor folësi, i shprehur edhe me përemrin vetor **unë**, realizon komunikimin në një të tashme objektive, në raport me kohën e thëniesimit, por asnjë dëshmi për kufij të kohëzgjatjes nuk mund të identifikohen brenda ligjërimit, përveç të ditur nga rrethana jashtëligjëimore. Vetë realiteti shkrimor që nga pikënisja e deri në përfundim nuk thotë më shumë se një përmbajtje komunikative, sado që është ‘materializim’ i aktit të të folurit dhe objekt shqyrtimi në kuptimin e një njësie gramatikore.

Pra, çdo thënie e realizuar nga një folës, në një moment të caktuar objektiv merr karakterizim kohor në bazë të tri pikëreferencave:

-çastit kohor kur flet, si e tashme objektive e folësit,
-mjetet gjuhësore që i zgjedh, për rastin tonë rëndësi kanë trajtat foljore përkatëse, si dhe

-segmenti real kohor i ndodhjes së ngjarjes që i referohet.

Çasti i ligjërimit duhet të ndriçohet në gjithë natyrën e tij ekzistenciale: **si çast, si shtrirje, si situatë më e gjerë** dhe këto tipare i merr në bazë të natyrës kontekstuale të komunikimit. Po ta bëjmë një korrelacion të çastit kohor objektiv, trajtës foljore dhe çastit të ligjërimit, s’ka si të mos dalë në pah se karakterizimi kohor i thënies merr ngjyrimin e saj pikërisht në bazë të këtyre pikave referenciale, të cilat mund të përkojnë ose jo me ngjarjen, e cila ndodh në një pikë kohore të caktuar dhe me perceptimin e saj objektiv nga folësi, i cili pastaj ia referon dëgjuesit a lexuesit.

Krejt ky proces del nga rrjedha kohore e një veprimi konkret, nga perceptimi mendor i folësit dhe nga paraqitja gjuhësore, e cila edhe mund të ketë interpretime subjektive, për motive nga më të ndryshmet. Kështu në shembujt konkretë:

-...ju lutem, nuk është as vendi, as koha. Mund të shihemi në ndonjë rast tjetër, të flasim sa të doni, por jo tani, sot më duhet të sajdis të ftuarit. (Kongoli, 2005, 99)

-...ja ku po ta them: edhe në **u dënosh**a ndonjë ditë dhe në **u vërtetoftë** se **të vrava** pas shpine, e vetmja gjë që **s'do të merret vesh** kurrë është pikërisht ajo që ti **kërk**on: shkaku. (Kadare, 2009, 87)

Identifikimi i folësit, si bartës aktual i mesazhit, është i qartë, po ashtu çasti i të folurit realizohet në të tashmen objektive, në raport me aktualësinë e ligjërimit, ndërsa ngjarjet që u referohet folësi u përkasin segmenteve kohore të ndryshme: në thënien e parë ato i përkasin një të ardhmeje të mundshme, të papërcaktuar kohësisht (*mund të shihemi, ...të flasim...*), në rastin e dytë kemi një situatë kur folësi u referohet ngjarjeve që u përkasin të tri boshteve kohore: të tashmes aktuale (ti **kërk**on), të shkuarës së papërcaktuar (se **të vrava** pas shpine), si dhe të ardhmes së mundshme a hipotetike (në **u dënosh**a..., në **u vërtetoftë**...).

Raportet e folësit me realitetin objektiv dhe qëndrimi subjektiv i tij ndaj realitetit pa dyshim ndikojnë në perceptimin realist të këtyre fakteve. Pastaj, duhet pasur parasysh sa edhe trajta foljore e përbart besnikërisht realitetin objektiv kohor, kurse e ç'natyre mund të jetë ndihma e elementeve të tjera leksikore në thënie të caktuara, në kuptimin e saktësisë kohore të saj, varet nga veshja leksikore e thënies së marrë në vëzhgim.

1.2.1. Folësi dhe çasti i ligjërimit

Me gjithë faktin se trajtat foljore, në kontekste të ndryshme përdorimi, shprehin veprime a gjendje që ndodhin objektivisht në momente kohore të caktuara, të motivuara a jo nga faktori njeri, ato, si të tilla në ligjërim domosdoshmërisht kanë të bëjnë me aspektin gramatikor. Funkcionin e këtij çasti në këtë kuptim e paraqet, veç shumë të tjerëve, edhe konstatimi: “Është pikërisht çasti i të folurit që përbën të veçantën e kategorisë gramatikore të kohës. Me çast të të folurit do të kuptojmë momentin kur folësi kumton diçka me gojë ose me shkrim”. (Memushaj, 2012, 241)

Përbërësit e çastit të të folurit janë:

- subjekti folës,
- segmenti i caktuar kohor, në të cilin ndodh akti i të folurit dhe
- ngjarja konkrete që konstatohet gjuhësisht nga folësi.

Derisa përcaktimi kohor i trajtave foljore sipas dy segmenteve kohore, e shkuar dhe e ardhme, bëhet nga realizimi i marrëdhënieve të kohës objektive me kohën gramatikore, veprimet e së tashmes përkrijnë me çastin kur flasim. Pra, situata e të folurit përkon me të tashmen kohore të folësit, ka një shtrirje kohore të pakufizuar gjuhësisht, por me caqe të nënkuptueshme, qoftë edhe nga rrethana jashtëgjuhësore, që nga pikënisja e aktit të të folurit, si gjendje komunikimi, deri në pikëpërfundimin e saj. Kështu në një fragment ligjërimit:

- **Rreth meje** është mbledhur myshku... Sepse që ta dini mirë, **unë** edhe ashtu **nuk thosha** asnjë fjalë **tash** e prej kohësh. **Heshtja ime** në shtëpi kishte filluar më herët, pak kohë para martesës, atëherë kur ime shoqe kishte thënë haptas se më kishte lexuar germë për germë, si një libër të hapur dhe nuk kishte për të mësuar asgjë të panjohur nga fshehtësitë e mia. (Basha, 2011, 28)

Pavarësisht vlerësimeve të ndryshme dhe thelbit të paqëndrueshëm nga aspekti i caqeve kohore me pika nisjeje dhe përfundimi konkret, identiteti i këtij fakti gramatikor, pra ai i çastit të të folurit, që domosdoshmërisht nënkupton edhe folësin, është i pakontestueshëm, sepse vetëm në raport me këtë “çast” dhe me funksionin referues të folësit trajtat foljore marrin vlerat e tyre kohore, respektivisht vishen me njohje, cilësi a peshë kategoriale relevante gramatikore. Në këtë kontekst mund të shtrohet çështja si karakterizohet tipari kohor në fjalitë me përmbajtje efektivisht reale dhe si në ato të modaliteteve të tjera, respektivisht a mund ta neutralizojë modaliteti i thënies kohën sintaksore (realitetin kohor) të saj?

Natyrisht se përgjigjja është negative, por gjithsesi kjo mund të ndikohet nga faktorë të tjerë, si nga liria e aktit të komunikimit të folësit, nga përzgjedhja e tipave të situacionit foljor apo të elementeve të tjera leksikore në shprehjen e një mendimi konkret, fakt që varet nga rrethanat socio-kulturore dhe ato subjektive, prandaj ‘funksioni shprehës’ i folësit (Dekry&Todorov, 1984, 467) mbetet i padiskutueshëm.

1.2.2. Identifikimi i folësit në ligjërim

Duke e parë, pra, funksionin e patjetërsueshëm referues të folësit në këtë kontekst, ngase vetë ekzistimi i nocionit **“çast i të folurit”** nënkupton praninë e një folësi, atëherë detyrë e parë del nevoja e identifikimit të këtij folësi në aktin e ligjërimit, respektivisht e funksionit të tij në këtë mes. Kështu në një thënie të kësaj natyre sintaksore:

-E shkunda edhe një herë kokën dhe vetëm tani e kuptova se qysh mbrëmë e kisha harruar radion të hapur. (Kadare, 2006, 119)

Folësi dhe çasti i të folurit janë në qendër të thënies, sepse vetëm në raport me të tashmen e folësit trajtat foljore i realizojnë kuptimet e tyre kohore: e kryera e thjeshtë e **kuptova** ndodh në të tashmen e folësit **tani**, derisa më se e kryera e **kisha harruar** e realizon kuptimin e saj në mënyrë të tërthortë në raport me të tashmen e folësit, e në mënyrë të drejtpërdrejtë në raport me një pikëmoment të së shkuarës, të shprehur me treguesin **qysh mbrëmë**. Pra, del se edhe roli i treguesve kohorë në thënie është të lokalizojë veprimin e shprehur foljor në një pikë kohore të caktuar, respektivisht ta konkretizojë një referim kohor të trajtës foljore në një kontekst të caktuar.

Në varësi nga konteksti ligjërimor, identifikimi i folësit në thënie të caktuara mund të bëhet në mënyra të ndryshme, por gjithsesi duhet të ketë gjurmë leksikore, sepse është moment kohor nga i cili, në kontekste të caktuara u jepet identitet kohor ngjarjeve të dhëna nga trajtat foljore, por mund të mbishtojë, sado që në mënyrë të kushtëzuar, edhe ngjyime të tjera. E sipas kësaj, roli i folësit në këtë mes del vetëm si referues, si subjekt folës që e paraqet atë pjesë të realitetit gjuhësisht në përmasat e tij reale, pa interferuar në karakterin e tij objektiv:

-Se çfarë ishte vërtet Cerberi, unë e mësova vite më vonë. Atë mbrëmje unë nuk e kisha njohur ende Sergerin, nuk e kisha dëgjuar as fjalën Cerber. Po kur u shfaq burri trupmadh befas, unë ngriva. Sot do të thosha, u hipnotizova. (Kongoli, 2005, 148)

Sado që folësi mund të ketë edhe ndikim subjektiv, ose së paku perceptime subjektive në ligjërim:

-Kishte aq shumë zhurmë, shtyrje e eufori, sa edhe sikur të kaloje lakuriq përmes sallës ku shërbeheshin kokteje e meze të ndryshme, nuk do të diktoheshe ose nuk do të merrej një veprim jashtë protokollit të festës... (Basha, 2011, 15)

Pra, del se folësi është në qendër të situatës komunikuese, prodhues i shprehjes, realizues i thënies dhe iniciues i një akti komunikimi, të cilin mund ta paraqesë krejt realisht, si një gjykim të verifikueshëm objektivisht a shkencërisht, ose edhe si një gjykim a perceptim krejt subjektiv, që mund të jetë real apo më pak real në raport me objektivitetin. Në këtë mes hyn edhe *kategoria kohore e përjetimit*: sa dhe si e ka përjetuar folësi ngjarjen, është vetë bartës, pjesëmarrës, dëshmitar ose vetëm informator i saj.

Siç u tha më lart, prania e folësit mund të identifikohet brenda strukturës ligjërimore nëpërmjet trajtës foljore, respektivisht mbaresave të saj vetore, elementeve të tjera në thënie (zakonisht përemrave vetorë), apo faktorëve të tjerë jashtëligjërimorë, fakte që kanë peshë në qasjen e analizës së kësaj natyre. Derisa në një thënie të tipit:

-Qysh kur jemi njohur, më ke pëlqyer gjithmonë...(Kadare, 2006, 129)


Folësi është bartës i veprimeve, të dy trajtat foljore të së kryerës **jemi njohur**, në fjalinë e parë dhe më **ke pëlqyer**, në fjalinë e dytë, kanë një pikëfillim të njëjtë dhe, ç'është më e rëndësishmja, kanë kohëzgjatje të njëkohshme, të cilat u referohen dy pikëmomenteve kohore: çastit të ligjërimit dhe çastit të veprimit foljor, i cili ndodhet në një pikë kohore objektive, të papërcaktuar, të së shkuarës, e shprehur me elementin leksikor të karakterit nisës, **qysh kur**, në raport me të cilat rrjedhimisht qëndrojnë në raporte njëkohësie. Pra, e kryera e dytë **më ke pëlqyer** ka një varësi relative kontekstuale nga e kryera e parë.

Në një kontekst tjetër ligjërimor, ku folësi ka identitet, por jashtë lidhjes së drejtpërdrejtë me çastin e ligjërimit, por i nënkuptueshëm në përjasje me treguesin **nesër**, ngjarjet u përkasin pikëmomenteve të së ardhmes dhe rrëfimi i tyre bëhet po nga një perspektivë e së tashmes së gjerë, si:

-Nesër do të më prisnin tek agjencia e vogël e qytetit. Unë do të zbrisja nga autobusi dhe do të takohesha me të gjithë ata me të cilët do të kaloja tërë jetën. Ndarjet do të ishin të shkurtra. Nuk do të kishte më ndarje të gjata. Me shokët e dhomës nuk dihej kur do të takohesha. Kur të takoheshim, do të kishim ndryshuar. Ndofta do të kishin filluar të na dilnin thinjat e para... (Lera, 1985, 186)

Pra, nëse thënie e kemi konceptuar si njësi e ligjërimit me funksion komunikues, me identitet gramatikor, semantik e intonacionor, pavarësisht skemës strukturore, atëherë mund të përfundojmë: në fjalinë e thjeshtë foljet përdoren duke e pasur pikëreferim momentin e të folurit, me folësin në qendër dhe aktiv në çdo segment kohor të thënies, duke realizuar kështu, sipas kriterëve tradicionale gramatikore, përdorimin absolut. Kjo nënkupton se megjithatë, jo vetëm në rrafshin gramatikor, por edhe në atë pragmatik, momenti kohor i një forme foljore edhe në këtë njësi sintaksore është i varur nga momenti kohor i të folurit, duke e relativizuar karakterin 'absolut' të përdorimit vetëm në nivelin e terminologjisë gjuhësore.

Mirëpo, në kontekste të tjera, pa lidhjen me momentin e të folurit, një fjali e thjeshtë mund të përdoret në kontekste rrëfimi, në kuadër të njërive tekstore, duke referuar në kohën e shqiptimit të thënies apo edhe në kohën e veprimit foljor, çështje që do të shtjellohen me një rast tjetër. Duke nxjerrë të dhëna statistikore rreth përdorimit të këtyre pikëreferimeve kohore në korpusin e shembujve të marrë për analizë në një punim më të gjerë, ka dalë se koha e të folurit dominon në raport me dy pikëreferimet e tjera në masën 68 për qind, koha e shqiptimit të thënies ka përdorim në masën 18 për qind dhe koha e veprimit foljor në masën 14 për qind, paraqitur në grafikonin vijues:



Përfundime

Identifikimi i shenjës kohore, nga e cila vendoset ngjarja e shprehur me trajtën foljore në kohë, natyra gramatikore e këtyre pikëmomenteve, si e çastit të ligjërit (e kohës së të folurit), e cila ka natyrë çastësore, shtrirje në kohë dhe si situatë më të gjerë, por edhe e pikëreferimeve të tjera, që nuk u trajtuan me këtë rast, del e natyrës së domosdoshme në kontekstin e përcaktimeve kohore të trajtave foljore të shqipes. Me gjithë peshën thelbësore të raporteve reale të ngjarjeve të vendosura në kohë, funksionit të pikëreferimeve kohore dhe faktorëve të tjerë kontekstualë, edhe jashtëligjërimorë, karakteri relativ i përcaktimit të kohës gramatikore mbetet i patejkalueshëm, sidomos në mekanizmin kompleks të sistemit foljor të shqipes.

Sa i përket natyrës së formave foljore në këto përdorime, nuk vërehen rregullsi përjashtuese: secila formë e sistemit foljor të shqipes mund të përdoret si në raport me çastin e të folurit, ashtu edhe në raport me pikëmomente të tjera me funksion referues kohor. Nuk mund të nxirren përfundime të besueshme a të argumentuara se një apo disa forma të caktuara foljore hyjnë në relacion vetëm me çastin e të folurit, e të tjera me pikëmomente të tjera kohore.

Referencat

- [1]. Antoni I. (2001): "Vremenska rečenica". Sremski Karlovci – Novi Sad
- [2]. Bokshi, B. (2012) "Format e futurit të shqipes në raport me ato të gjuhëve ballkanike", në "Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit", ASHAK, Prishtinë
- [3]. Belaj B. (2003): "Kategorija gotovosti i vremenska vrijednost pasivnog predikata", Osijek
- [4]. Badurina L. (2012): "Vremenski odnosi na razini složene rečenice i teksta", Dubrovnik
- [5]. Badurina L. (2014): "Vrijeme u tekstu", Rijeka
- [6]. Comrie B. (2000): "Tense", Cambridge, Cambridge University Press
- [7]. Demiraj Sh.(1988): "Gramatika historike e gjuhës shqipe", Prishtinë
- [8]. Demiraj Sh.(1971): "Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe", SF/4, Tiranë
- [9]. Dykro O., Todorov C. (1984): "Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërit", Prishtinë
- [10]. Duro A. (2001): "Terminologjia si sistem", Tiranë
- [11]. Dhrimo A. (1996): "Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe", Tiranë
- [12]. Dhima Th. (2002): "Faza me fjali të nënrenditur kohore", Tiranë
- [13]. Dhima Th. (2013): "Faza me fjali të nënrenditur përcaktore-ndajshimore të kohës", Tiranë
- [14]. Fiedler W. (1984): "Struktura e kategorisë së kohës në gjuhët e Ballkanit", në GJA, nr.14, Prishtinë
- [15]. Fleischman S. (1990): "Tense and Narrativity. From...." Austin, University of Texas Press
- [16]. Grafi G. (2003): "Sintaksa", Tiranë
- [17]. Ismajli R. (1985): "Shumësia e tekstit", Prishtinë
- [18]. Koleci F., Turano G. (2011): "Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes", Tiranë
- [19]. Kelmendi T. (1993): "Funksionet e kohës foljore të pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare", Prishtinë
- [20]. Kelmendi T. (2006): "Kështjellat e sintaksës", Prishtinë
- [21]. Kelmendi T. (2008): "Studime sintaksore", Prishtinë
- [22]. Kordić S. (1995): "Relativna rečenica", Zagreb
- [23]. Likaj E. (2002): "Mbi vendin e mjeteve të eptimit në gjuhën shqipe", SF, nr.3-4, Tiranë
- [24]. Likaj E. (2005): "Fleksioni indoevropian", Tiranë
- [25]. Likaj E. (2006): "Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe", Tiranë
- [26]. Lyons. J. (2001): "Hyrje në gjuhësinë teorike", Tiranë
- [27]. Memushaj R. (2012): "Morfologjia e eptimit të shqipes standarde", Tiranë
- [28]. Panolli J. (1992): "Çështje të sistemit kohor të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe", në SF, nr.1-4, Tiranë
- [29]. Pranjković I. (2016): "Gramatika u riječima i riječi u gramatici", Matica Hrvatska, Zagreb
- [30]. QSA (2016): "Kërkime gjuhësore", Tiranë
- [31]. Riza S.(1984): "Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore", Tiranë
- [32]. Rugova L. (2008): "Koncepti i fjalisë në gramatikën e tekstit", SNGJLKS, 26, Prishtinë
- [33]. Topalli K. (2011): "Sistemi foljor i gjuhës shqipe", Tiranë
- [34]. Sadiku Z. (1975): "Funksionet dhe veçoritë semantike të trajtave gramatikore të kohës së shkuar të gjuhës shqipe" (punim disertacioni), Prishtinë
- [35]. Sadiku Z. (1980): "Koha objektive, ajo gramatikore dhe tipat e të folurit" në GJA, SSHF VII, Prishtinë.